



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 9702 Prot

Vlorë, më 20.06 2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 27 qershor 2024.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË

PREFEKTIT TË QARKUT VLORË

Ju njoftoj se, **ditën e enjte, datë 27.06.2024, ora 10:00**, në pallatin e kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas pikave ;

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, datë 29.05.2024.
2. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 43 - 48, datë 29.05.2024;

Do të vazhdojmë me këtë Rend Dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin maj 2024”
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin maj 2024”.
3. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia si, dhe humbja e jetës së z.Thoma Loli, në banesën e z.Jurgen Loli dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”
4. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Ëngjëll Kolila dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
5. Projektvendim “Për një ndryshim në VKB Nr 100, datë 29.12.2023, “Për buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024”.

6. Projektvendim “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Etikës, Standarteve dhe Apelimeve, në Këshillin e Bashkisë Vlorë “
7. Projektvendim “ Për disa korrigjime dhe saktësime në VKB Nr 31, datë 02.04.2020 “Për miratimin e kodit të sjelljes dhe rregullave, për parandalimin e konfliktit të interesave të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë “
8. Projektvendim “Për miratimin e Rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si, dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë”
9. Projektvendim “ Për emërtim rruge, në territorin e Bashkisë Vlorë”
10. Projektvendim “Për miratimin e sheshit “Detarët Shqipëtar” dhe, vendosjen e memorialit me simbolet e detarisë , në territorin e Bashkisë Vlorë “
11. Projektvendim “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe, vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.
12. Të ndryshme.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :
Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.06 .2024, ora 10:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.06.2024, ora 11:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.06.2024, ora 12:00.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri

